



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA PATOS**  
**KËSHILLI I BASHKISË**  
**KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK**

Nr. 1489 / Prot.  
13.1

Patos, më 12 / 07 / 2022

**PROCES-VERBAL**

I mbajtur sot në datë 08.07.2022 ora 11:00, në ambientet e shkollës së fshatit Grizë zhvillohet dëgjesa publike me temë: **“Sistemimi i hapësirave rekreative të shkollës Grizë”**

Pjesëmarrës në këtë dëgjese publike:

1. Përfaqësues të Z.V.A Patos
2. Banorë të zonës fshati Grizë
3. Përfaqësues të Shoqërisë Civile
4. Koordinator i Konsultimit Publik
5. Përfaqësues të Bashkisë Patos

Takimi hapet nga Drejtor i Drejtorisë së Hartimit të Projekteve ,Monitorimit të Investimeve dhe Shërbimeve z. Arben Manoku.

Arben Manoku – të nderuar të pranishëm më lejoni që përpara se të prezantohem t’ju falenderoj për prezencë tuaj në këtë takim konsultativ. Sot me ne i pranishëm është edhe përfaqësuesi i zyrës Vendore Arsimore Patos. Sic dhe jeni në dijeni në bazë të njoftimit të ardhur nga kooordinatori i konsultimit dhe këshillit të bashkisë takimi i sotëm ka të bëjë lidhur mbi ambientet e jashtme të godinës e shkollës. Të ndodhur në këto kushte dhe përpara faktit kur kjo godinë nuk mund të riparohet ne kërkojmë të ngremë një godinë të re për kopësht por si fillim duam të marrim mendimin tuaj si banorë të fshatit se cfarë realisht ju doni që te bëjmë me territorin e ish shkolles fillore Grize. Aktualisht fëmijët e fshatit janë në një godinë private por duke qenë se ne e kemi hapësirën kemi menduar të ndërtojmë një kopësht për fëmijët

Agim Cjapi – ne do të donim të ishte Kryetarja prezent pasi kërkesa jonë ka qenë e qartë qysh në fillim kur u mbyll shkolla.

Arben Manoku – Kryetarja për shkak të impenimeve të saj nuk mund të jetë prezent. Por ne jemi këtu për të marrë kërkesat tuaja se cfarë realisht kërkonit ju si banorë të ndërtohet në këtë ambient pavarësisht propozimit tonë. Në fund do të vendoset ajo që ju realisht doni të bëhet.

Dashuri Hasanaj – kopshti duhet të qëndrojë kurse fëmijët për shkollë jo? Përse unë duhet të nxjerr fëmijët në rrugë për ti cuar në shkollë kur shkollën e kam në lagje? Ky komunitet kërkon shkollë.

Arben Manoku – ne këtu jemi për bashkëbisedim dhe nuk e përjashtojmë mundësinë për ndërtimin e një godinë për shkollë.

Dashuri Hasanaj – kjo godinë është vlerësuar nga eksperti dhe mund të riparohet përse duhet ta prishni? Ne duam shkollë për fëmijët.

Arben Manoku – unë e njoh ekspertin e marrë prej jush i cili ka hedhur mendimin se kjo godinë mund të riparohet por nuk ka dhënë ndonjë garanci për rezistencë e godinës pasi sot që ne flasim godina nuk bie por në rast se ka lëkundje sizmike godina e shkollës rrezikon të shembet. Edhe ekspertët e Insitutit të Ndërtimit janë në të njëjtë me mendimin tonë që kjo godinë nuk garanton sigurimin e kushteve normale për zhvillimin e procesit mësimor.

Engjëll Buba- pavarësisht propozimit tuaj për këtë objekt unë mendoj por kam përshtyjen se të gjithë do të jenë në të njëjtim mendim me mua se shkolla mund ta priset por ne si banorë kërkojmë nga ana juaj që të ndërtohet një shkollë e re me këtë planimetri dhe nëse është e mundur të shtohen edhe dy klasa të tjera ku njëra të jetë për kopësht dhe cerdhe për fëmijët ndërsa lidhur mbi oborrin e shkollës para dhe pas saj propozoj që të bëhet kënd sportiv bolejbol me lulishte dhe stola, ndricim nga të gjitha anët dhe të ketë ambient shlodhës për moshën e tretë, kënde lojrash për fëmijë gjithash të jetë e hapur si ambient në cdo orë të ditës me qëllim për ti shërbyer cdo banori.

Arben Manoku- bashkia ka godinën ndërsa programi mësimor është i ZVA-së pasi varet nëse ka numer fëmijësh apo jo sipas procedurave dhe rregulloreve të miratuara nga Ministria e Arsimit.

Momoza Fetahu – nëse është shkolla, fëmijët nuk ikim, pasi nuk kam përse të coj fëmijën te shkolla “Hekuran Maneku” dhe as në privat nëse shkollën e kam këtu

Vasilika Salija – ne duam të ketë edhe cerdhe dhe kopësht edhe shkollë

Agim Cjapi – në këtë lagje ne duam që kjo hapësirë të jetë multifunksionale shkollë, kopësht kënd sportiv dhe ambiente rekreative dhe të jetë i hapur për banorët në cdo orë të ditës

Ali Xhaferraj – ju thoni se kjo godinë do të priset dhe nëse do të bëhet godinë e re të bëhet shkollë fillore

Fatmir Saliaj – shkolla të mbetet shkollë nuk ka rëndësi nëse e riparoni apo ndërtoni një të re por ne kërkojmë edhe kopësht edhe cerdhe pasi janë 6 dylm tokë në këtë ambient që ju shikoni por mendoj që të bëhet edhe një abient për kryesinë e fshatit

Arben Manoku- objekti nuk do të ndryshojë funksionin e tij do të jetë objekt me karakter arsimor

Gjergji Stefallari| Përfaqësues i ZVAPatos|– mendoj se kërkesat duhet të bëhen në funksion të hapësirave reale të territorit të shkollës

Bardhyl Ruzhdia – fshati Frizë i plotëson të gjitha kushtet për të pasur një shkollë pasi jemi rreth 400 familje

Agim Cjapi – nuk mendoj se ka ardhur një kërkesë e vetme nga banorët e Grizës që nuk duan shkollë.

Arben Manoku – abosutisht që jo

Jonuz Meta - ne jemi të të njëjtit mendim si banorë për ekzistencën e shkollës kopshtit cerdhes këndeve sportive dhe ambienteve shlodhëse për ne si pensionistë brenda këtij trualli dhe kërkoj që ju të bashkisë përpara se të bëni investimin të na prezantoni projektin e hartuar që dhe ne të jemi të qartë se çfarë do të bëhet në këtë ambient. ashtu sic erdhët sot për të na marrë mendim të vini me projekt në ë dorë dhe të na e paraqisni në detaje

Fatmir Saliq – jam dakort me mendimin e Jonuzit që projekti të na prezantohet këtu në këto ambiente pasi vetëm kështu mund të sigurohemi se këtu do të bëhet ajo që nuam ne si banorë.

Arben Manoku – jam plotësisht dakord me propozimet tuaja. Nëse dikush ka ndonjë mendim tjetër? M.q.se jo mendoj se takimi ia arriti qëllimit, unë ju falenderoj edhe një herë me shpresë për tu riatakuar përsëri në takimin e ardhshëm të prezantimit të projektit.

Konceptoi:  
Koordinator Konsultimin Publik  
Suzana Hysenaj



Sekretar Këshilli  
Balil Balili





Grizë më, 08.07.2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA E PATOS

LISTË-PREZENCË PËR PJESËMARRJE NË DËGJESË PUBLIKE ME TEMË:

“SISTEMIM I HAPËSIRAVE REKREATIVE TË SHKOLLËSGRIZË”

Nr	Emër	Mbiemër	Njësia/ Qyteti/ Fshati	pozicioni/ Profesion	Nr. Kontakti	Firma
1	Artur	Shpevdhja	GRIZ	profetori	0692321538	AS
2	Hajset	shpevdhja	griz	REGJONT	0682990747	DEJAY
3	Billail	Aday	griz	pa pun	0692679102	DEJAY
4	Fatmir	Selaj	GRIZË	A. kryesie	0684235046	DEJAY
5	Enojer	Budha	griz	Banues	0692471314	AS
6	Artur	Budha	griz	Banues	0698598141	AS
7	Adi	Khoperof	griz	BAJOT	0682896387	DEJAY
8	Mimona	Tetare	griz	BAJOT	0682336679	DEJAY
9	Edlira	Jsyfi	Griz	Banore	0683132347	DEJAY
10	Rozeta	Metaj	Griz	Perjont	0686189003	DEJAY
11	Bashkim	Rushitaj	GRIZË	Rihotari	0682618328	DEJAY
12	Dashuri	Haxhami	Griz	banore	0692832434	DEJAY
13	Gedem	Ghaxhoollari	GRIZ	BANUES	0694301577	DEJAY

Në zbatim të Ligjit Nr.9887, datë 10.3.2009 "Për Mbrojtjen E Të Dhenave Personale", Neni 10 "Përpunimi për kërkime shkencore dhe statistike" I të dhenave personale, të mbledhura për çfarëdolloj qëllimi, mund të përpunohen më tej vetëm për qëllime shkencore ose statistike, duke siguruar se nuk janë përpunuar, për të marrë masa ose vendime për një individ.. Përpunimi i të dhenave personale lejohet të përdoren vetëm për qëllime gazetarie, literature ose artistike. Përfshihet nga zbatimi i neneve 5, 6, 7, 8, 12, 18, 21 e 28 të këtij ligji, vetëm nëse mbrojtja e të dhenave personale, sipas këtyre dispozitave, pengon ushtrimin e së drejtës së lirisë së shprehjes



Grizë më, 08.07.2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS

LISTË-PREZENCË PËR PJESËMARRJE NË DËGJESË PUBLIKE ME TEMË:

“SISTEMIM I HAPËSIRAVE REKREATIVE TË SHKOLLËSGRIZË”

Nr	Emër	Mbiemër	Njësia/ Qyteti/ Fshati	pozicioni/ Profesion	Nr. Kontakti	Firma
1	Edmond	Xhajoxhaj	GRIZË	BANOR	0682520797	Ego
2	Mami	Sahaj	GRIZË	SHKOLLË	069, 98, 39, 7454	
3	Konrad	Antonaj	GRIZË	BANOR	069, 8189881	
4	Vasilita	Sabiro	GRIZË	BANOR	068 7603922	
5	Edmond	Spahiu	PATOS	ZVAP Patos	0683949375	
6	Alim	Çipi	GRIZË	BANOR	0694903977	
7	Arben	Spahiu	GRIZË	Jp Sh. Social		
8	Arben	MAKOKA	PATOS	Dr. SHERBIJEVE	0697538357	
9	Suzana	Hysenaj	Patos	Koordinator Konsultimi	0684881460	
10						
11						
12						
13						

Në zbatim të Ligjit Nr.9887, datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen E Të Dhenave Personale”, Neni 10 “Përpunimi për kërkime shkencore dhe statistikore” I të dhënave personale, të mbledhura për qëllime të tjera, mund të përpunohen në mënyrë të përpunueshme ose statistikore, duke siguruar se nuk janë përpunuar, për të marrë masa ose vendime për një individ.. Përpunimi i të dhënave personale lejohet në mënyrë të përdorur vetëm për qëllime gazetarie, literature ose artistike. Përfshihet nga zbatimi i neneve 5, 6, 7, 8, 12, 18, 21 e 28 të këtij ligji, vetëm nëse mbrojtja e të dhënave personale, sipas këtyre dispozitave, pengon ushtrimin e së drejtës së lirisë së shprehjes